



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës

Opština Priština –Municipality of Prishtina



## KONTRATË

Numri i kontratës<sup>1</sup>: 616-22-8735-2-1-1/C1084

**KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES** (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe  
Florije Jahaj. rr.C, nr.30, Matiçan, Prishtinë, 810545907, (ne vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), ne anën  
tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për shërbimet e shënuara me poshtë:  
**Hartimi i Zgjidhjes urb-arkitektonike e ndërlidhjes së lagjes "Kalabria" me lagjen "Dardania "** me  
Numër identifikues: 616-22-8735-2-1-1dhe numer te brendshem 616 22 124 211

### Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit te Shërbimeve:

**Zgjidhja urb-arkitektonike e ndërlidhjes së lagjes "Kalabria" me lagjen "Dardania "**

No.	616 22 124 211
1	Hartimi i Zgjidhjes urb-arkitektonike e ndërlidhjes së lagjes "Kalabria" me lagjen "Dardania "

### Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë: 218,429.80 €; [Dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind e njëzet e nentë euro e tetëdhjetë eurocent].

2.2 Çmimi i përmendor në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit te Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhc/ose të Veçanta të kontratës.

### Neni 3 Rendi i përparsësë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit te Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknikë;
- (e) Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësës osc divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparsësë në të cilin janë dhënë më sipër.

<sup>1</sup> Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesin.

Neni 4

### Komunikimet


4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit te Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënen e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përvèç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" "ose" vendosë "do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën në tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Ofruesin e Shërbimeve.


#### Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Visar Shehu
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	14.02.2023
Vula:	



(Ne rast te kontratave me vlerë te madhe)

Emri:	Përparim Rama
Pozita:	Zyrtar Kryesor Administrativ
Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	



#### Për Ofruesin e Shërbimeve

Emri:	VETON JAHAJ
Pozita:	Drejtore Ekzekutiv
Nënshkrimi:	
Data:	06.03.2023
Vula:	



# KUSHTET E PËRGJITHSHME

Numri i kontratës: 616-22-8735-2-1-1/C1084

## Neni 1 Përkuftimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "Shërbimet" do të thotë shërbimet qe do te ekzekutohen nga ana e Ofruesit e Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshtimin e Çmimit te përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 "Ofrues i shërbimeve" është Operatori Ekonomik ose grapi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 "Personeli" do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 "Çmimi i kontratës" do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 "Nënkontraktuesi" do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 "Palë" nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe "Palët" nënkupton të dy prej tyre.

1.8 "Autoriteti Kontraktues" nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 "KPK" nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "KVK" nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

## Neni 2 Ligji i aplikueshëm dhe gjuha

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

## Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përsitim apo interes nga ajo, përvèç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënes së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguruesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënen e kontratës përvèç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

## Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjesë të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura

Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit te ofertës. Ne rast te ndryshimt te nënkontraktuesve gjate implementimit te kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet te njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet te përmblushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

#### Neni 5 Tatimet dhe Doganat

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha taksat dhe doganat në pajtim me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Ofruesi i Shërbimeve, Nënkontraktuesit, dhe Personeli i tyre do t'i paguaj ato taksa, dogana, tarifa dhe detyrime të tjera që mund të vendosen sipas ligjit në fuqi, shuma e të cilave mendohet të ketë qenë e përfshirë në çmimin e kontratës.

#### Neni 6 Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve

6.1 Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të kontratës nga të dy palët ose ne një date tjeter të mëvonshme siç mund të ceket në KVK.

6.2 Para fillimit të Shërbimeve, Ofruesi i Shërbimeve do të dorëzoj Autoritetit Kontraktues për miratim një Program që tregon metodat, aranzhimet, rendin dhe kohën për të gjitha aktivitetet. Shërbimet do të kryhen në pajtim me programin e miratuar.

6.3 Ofruesi i Shërbimeve do të filloj shërbimet sa më shpejt që është arsyeshëm e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.4 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, siç është e specifikuar në KVK. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të gjitha aktiviteteve.

6.5 Vendi i kryerjes së shërbimeve është i përcaktuar në KVK.

6.6 Përveç nëse palët pajtohen që të bëhet ndryshe, ekzekutimi i kontratës do të fillojë jo më vonë se 90 ditë pas njoftimit të dhënies së kontratës. Pas kësaj date Ofruesi i Shërbimeve do të ketë të drejtë të mos e ekzekutojë kontratën dhe ta marrë ndërprerjen e saj ose kompensimin për dëmin që i është shkaktuar. Ofruesit të Shërbimeve do t'i merret kjo e drejtë, përveç nëse e ushton brenda 30 ditësh pas skadimit të periudhës 90-ditore.

#### Neni 7 Zgjatja e periudhës së përfundimit

7.1 Ofruesi i Shërbimeve mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsyet:

- Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- forca madhore siç është e definuar në Nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëj një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përvëçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjtia pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

## Neni 8 Forca madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë *madhore*" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetat, shtrëngatat, vetëtima, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksploidimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngashme e paparashikuar që është përtëj kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paaftësinë e një pale të tillë që të përbush detyrimet e saj tanë e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjaljen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrin, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tillë alternative përvëç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

## Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhreve administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtronet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- (e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- (g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korruption, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;
- (h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përvëç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- (i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;
- (j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpërt kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

#### Neni 10 Ndërprerja nga ana e Ofruesit të Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

- a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;
- b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paafshi të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) te Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

#### Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofruesi i Shërbimeve do të kryej Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të veprojë sipas urdhreve administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Ofruesi i Shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtëj fushëveprimit të kontratës, ai, duke ju ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njostojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njostimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmët e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.5 Nëse Ofruesi i Shërbimeve është konsorcium i dy ose më tepër personave, të gjithë personat e tillë do të jenë bashkërisht dhe vazhdimisht të obliguar t'i plotësojnë kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi që të veproj në emër të tij për qëllime të kësaj kontrate do të ketë autoritetin që të lidh konsorciumin. Përbëja e grupit nuk do të ndryshohet pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësoj personelin kyç të identifikuar në tender e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë ekzekutimit, dhe në bazë të kërkesës me shkrim dhe të arsyetur, autoriteti kontraktues mund të kërkojë për një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryen detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të propozuar të personelit kryesor, vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë janë thelsisht të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuara.

## **Neni 12              Obligimet e Autoritetit Kontraktues**

12.1 Autoriteti kontraktues do t'i ofrojë ofruesit të shërbimeve menjëherë ndonjë informacion dhe/ose dokumentacion në dispozicion t'ë tij, që mund t'ë jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente t'ë tilla do t'i kthehen Autoritetit Kontraktues në fund t'ë periudhës së zbatimit t'ë detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do t'ë bashkëpunoj sa më shumë që është e mundur me Ofruesin e Shërbimeve për t'i siguruar informacione që ky i fundit mund t'i kërkoj në mënyrë t'ë arsyeshme për kryerjen e kontratës.

12.3 Autoriteti Kontraktues do t'ë caktoj "Menaxherin e Projektit", i cekur në KVK, i cili do t'ë jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

## **Neni 13              Dëmet e likuiduara**

13.1 Ofruesi i Shërbimeve do t'ë paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore t'ë cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve t'ë likuiduara nuk duhet t'ë tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund t'ë zgres dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak t'ë Ofruesit të Shërbimeve. Pagesa e dëmeve t'ë likuiduara nuk do t'ë ndikoj në detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse Data e përfundimit është zgjatur pasi që janë paguar dëmet e likuiduara, Autoriteti kontraktues do t'ë përmirësojë çdo pagesë t'ë tepertë t'ë dëmeve t'ë likuiduara nga ofruesi i shërbimit, duke rregulluar certifikatën e ardhshme t'ë pagesës.

## **Neni 14              Siguria e ekzekutimit**

14.1 Ofruesi i Shërbimeve do t'ë, jo më vonë se dita e nënshkrimit t'ë kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim t'ë plotë dhe t'ë mire t'ë kontratës. Shuma e sigurisë do t'ë saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do t'ë ndalet nga pagesa e Autoritetit Kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit t'ë plotë dhe t'ë duhur t'ë obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Siguria do t'ë vazhdoj t'ë jetë valide 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

14.3 Siguria e ekzekutimit t'ë kontratës do t'ë jetë në formën e dhënë në pjesën IV t'ë kontratës.

## **Neni 15              Sigurimi që do t'ë merret nga ofruesi i shërbimeve**

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do t'ë marr dhe do t'ë ruaj, dhe do t'ë shkaktoj Nënkontraktorët t'ë marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë t'ë kushteve t'ë miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rrëziqet, dhe për mbulim, siç do t'ë specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë t'ë Autoritetit Kontraktues, do t'ë ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

## **Neni 16              Parimet e përgjithshme t'ë pagesës**

16.1 Pagesat do t'ë bëhen në Euro. Metoda dhe kushtet e pagesës që duhet t'i behet Ofruesit të Shërbimeve sipas kësaj Kontrate do të specifikohen ne KVK.

16.2 Pagesat që duhet te bëhen sipas saturës se lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do t'ë bëhen në llogarinë bankare t'ë dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjtë formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet t'ë përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.3 Shumat duhet t'ë paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në t'ë cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do t'ë jetë data në t'ë cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do t'ë jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.4 Periudha prej 30-ditësh mund t'ë pezullohet duke e lajmëruar Ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund t'ë plotësohet sepse shuma nuk do t'ë paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund t'ë mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund t'ë bëhet një inspektim i menjëherëshëm për qëllim t'ë kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do t'ë japë sqarime, modifikime apo informata t'ë tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do t'ë llogaritet nga data në t'ë cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.5 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.3, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.6 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.3 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

#### Neni 17 Kontrolli i kualitetit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njostojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është si në KVK.

#### Neni 18 Korrigjimi i defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njostojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektit të korrigohen.

18.2 Sa herë njostimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njostuar brenda kohës së specifikuar në njostimin e Autoritetit Kontraktues.

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njostimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

#### Neni 19 Konsekuençat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) Dëme të përgjithshme; ose
- b) Dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

#### Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekë për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetren me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetren.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpilen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

**Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

**Neni 22 Dëmshpërbllimi**

22.1 Ofruesi i shërbimeve do te mbroje dhe do te dëmshpërbuje Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do te jetë përgjegjës për te gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshire por jo kufizuar shpenzimet e tarifës se avokateve dhe shpenzimet në lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit te Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti te siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

**PJESA III E KONTRATES KUSHTET E VEÇANTA**


KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksoni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe.
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	6.1	180 DITE
	6.5	Vendi i kryerjes së shërbimeve është <i>Prishtine</i>
Obligimet Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit caktohet me vendim nga ZKA
Dëmet likuiduara	13.1	Norma e dëmeve të likuiduara është 0.25% e Çmimit final të Kontratës në ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është 10% të çmimit final të kontratës.
Siguria ekzekutimit	14.1	Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është <b>10%</b> me vlefshmëri prej 210 DITEVE
Parimet përgjithshme të pagesës	16.1	Pagesa do të bëhet nga ana e Autoritetit Kontraktues për shërbimet e kryera vetëm në bazë të shumës së vlerës së një Urdhër Blerje te vlefshme të lëshuar nga autoriteti kontraktues
Kontrolli kualitetit	17.1	Monitorimi dhe vlerësimi behet nga Menaxheri i Projektit dhe Organimi mbikëqyrës i projektit
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Komisioni për Ndërmjetësim ne kuadër te Ministrisë se Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përherëshëm i

		<p>Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</p> <p>Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin përmenyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</p>
--	--	--

OFERTA FINANCIARE E OPERATORIT EKONOMIK

Nr.	Përshtimi i pozicionit	Njësia	Sasia (a)	Cmimi (€) (b)	Gjithësej (€) (a) x (b) = (c)
1.	<p>Studim Fizibiliteti për projektin "Zgjidhja urbar-arkitektonike e ndërtimit së lagjes "Kalabria" me lagjen "Dardania".</p> <p>Vëmendje: Në çmim duhet të jenë të përfshira gjitha pikat e cekura në Termat e References.</p>	Studimi 1 Fizibiliteti	1	185,110.00  185,110.00	185,110.00  185,110.00

MTSH (UFRATEC)  
 VETON JAHEN  
 DREJTORE E DHEZON J. B.H.  
  
 INERATEK  
 Engineering  
 PRISHTE  
*[Handwritten signature over the stamp]*  
12.10.2012

## ANEKS 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

<b>1. HISTORIKU</b>	
<b>1.1 Shteti përfitues</b>	Republika e Kosovës
<b>1.2 Autoriteti Kontraktues</b>	Komuna e Prishtinës, Drejtoria e Urbanizmit, Arber Sadiki
<b>1.3 Historiku përkatës i vendit</b>	<p>Prishtina është kryeqytet i Republikës së Kosovës. Ka një sipërfaqe gjeografike prej 572 km<sup>2</sup>. Prishtina është qytet historik e cila gjendet në pjesën veriperëndimore dhe shtrihet buzë rrafshnaltës së plleshme rrëzë maleve të argjendta. Ashtu si dikur Ulپiana, ka pozitë të përshtatshme gjeografike, pasi gjendet në kryqëzimet parësore kontinentale. Në Prishtinë jetojnë Shqiptarët, por jetojnë edhe komunitetet tjera të vogla, si Serbët, Turqit, Boshnjakët, Romët, Ashkalit etj. Prishtina vizitohet edhe nga shumë vizitore të huaj. Në Prishtinë bëhet qarkullimi kryesor i mallrave dhe i bizneseve në Republikën e Kosovës. Pra Prishtina gravitohet nga banorët e të gjitha qyteteve të Kosovës dhe është qendra kryesore e zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme kulturore, sportive, të biznesit etj. Në aspektin ndërtimor zhvillimi i Prishtinës ka pas një rritje të hovshme, si në objekte banimi, sportive, infrastrukturë rrugore, rrjetë të kanalizimit, ndërtim të hapësirave gjelbëruese etj. Por Prishtina si qendër kryesore e Republikës së Kosovës, gjithmonë ka nevoja që të rritë dhe të modernizoj infrastrukturën e vetë rrugore në mënyrë që jeta e banorëve të saj dhe po ashtu e njerëzve që e gravitojnë nga gjitha anët e Kosovës të lehtësohet. Në kuadër të kësaj do të jetë edhe projekt "Zgjidhja urb-arkitektonike e ndërlidhjes së lagjes "Kalabria" me lagjen "Dardania "</p>
<b>2. OBJEKTIVA, QELLIMI &amp; REZULTATET PRITURA</b>	<p>Objektivat e projektit janë krijimi i lidhjeve me rrugët lidhëse për automjete, të këmbësorëve dhe çiklizmit ndërmjet Dardanisë dhe Kalabrisë dhe gjithashtu futja e objekteve të reja të parkut, si dhe shtimi i sipërfaqeve të gjelbërtë.</p> <p>Rruja ekzistuese (M2) Jusuf Gërvalla krijon probleme të ndotjes së ajrit dhe zhurmës dhe vepron si barrierë midis lagjeve, gjë që inkurajon përdorimin e makinave për udhëtime të shkurtra në qytet.</p> <p>Rezultat i projektit është ndërtimi i nënkalimit (Tunelit) që do të lidhë lagjen Kalabria me Lagjen Dardania si dhe ndërtimin e parkut të ri urban në Lagjen Kalabria.</p> <p>Për të arritur objektivat, qëllimin dhe rezultatin e projektit "Zgjidhja urb-arkitektonike e ndërlidhjes së lagjes "Kalabria" me lagjen "Dardania", Komuna e Prishtinës do të angazhoj operator ekonomik i cili në këtë fazë të projektit do të bëjë studimin e realizueshmërisë (Feasibility Study) së projektit apo Studimin e Fizibilitetit të projektit.</p>
<b>2.1 Qëllimi përgjithshëm</b>	<p>Studimi i zonës ku do të realizohet projekt "Zgjidhja urb-arkitektonike e ndërlidhjes së lagjes "Kalabria" me lagjen "Dardania"</p> <p>Titulli i kontratës: Studimi i fizibilitetit për projektin "Zgjidhja urb-arkitektonike e ndërlidhjes së lagjes "Kalabria" me lagjen "Dardania"</p>
<b>2.2 Qëllimi</b>	Qëllimi është evidentimi i vlefshmërisë së projektit "Zgjidhja urb-arkitektonike e ndërlidhjes së lagjes "Kalabria" me lagjen "Dardania"
<b>2.3 Rezultatet që duhet arrihen nga OE</b>	Detyra specifike të detyrueshme për operatorin ekonomik:

Përgatitjen e Studimit të Fizibilitetit për projektin " Zgjidhja urb-arkitektonike e ndërlidhjes së lagjes "Kalabria" me lagjen "Dardania "

Operatori Ekonomik do të sigurojë një studim fizibiliteti i cili do të përfshijë:

- Paraqitura e gjendjes aktuale e zonës ku do të bëhet " Zgjidhja urb-arkitektonike e ndërlidhjes së lagjes "Kalabria" me lagjen "Dardania "
- Përcaktimi i gjitha llojeve të standardeve të domosdoshme të aplikohen për projektin " Zgjidhja urb-arkitektonike e ndërlidhjes së lagjes "Kalabria" me lagjen "Dardania "
- Analiza ekonomike dhe financiare për projektin " Zgjidhja urb-arkitektonike e ndërlidhjes së lagjes "Kalabria" me lagjen "Dardania ",
- Evidentimi i Përfituesve direkt dhe indirekt nga investimet e projektit " Zgjidhja urb-arkitektonike e ndërlidhjes së lagjes "Kalabria" me lagjen "Dardania "
- Studimi i zonës dhe evidentimi i efekteve (pozitive dhe negative) të projektit,
- Katër variante projektimi, që do të zhvillohen pas vlerësimit fillestar të studimit dhe informacioneve të tjera teknike. Gjatësia e trajtimit rreth 1000 m dhe Gjerësia e trajtimit rreth 50m. Variantet e projektimit mund të përfshijnë:
  - Idetë e propozuara duhet të janë funksionale dhe të janë të optimale në aspektin ekonomik.
  - Idetë duhet të bëjnë të mundur qarkullim të lehtë si për rrugë " Jusuf Gërvalla " po ashtu edhe për lagjet Kalabria dhe Dardania,
  - Idetë duhet të përfshijnë konstruksione nëntokësore (si tunele, nënkalime apo forma tjera) dhe konstruksione mbi tokësore (si ura, mbikalime dhe forma tjera), duke paraparë pjesët e rregullimit të ambientit (mbjellje drunjësh, gjelbërim etj).
  - Parashikimi i rrugëve qarkulluese për kategoritë me nevoja të veçanta, për këmbësorët, për çiklistët dhe tjera.
  - Studimi socio-ekonomik që vlerëson gjendjen bazë dhe që vlerëson ndikimet e varianteve.
  - Përshkrimi i gjendjes aktuale e zonës ku do të kryhet projekti, pra variantet,
  - Matjet e detajuara gjeodezike të vendit ku do të bëhen variantet projektuese,
  - Analiza në detaje e funksionimit për secilin variant dhe rekomandimet profesionale për secilin variant.
  - Vlerësimi i në aspektin ligor dhe planifikues të katër variantave dhe dhënia e rekomandimeve profesionale.
  - Fazat e propozuara të projektit për variantet , duke përfshirë mbylljet e përkohshme të rrugëve, gjatë ekzekutimit të projektit në teren.
  - Dukjet-skicat funksionale të infrastrukturës rrugore për katër variantet dhe mënyrat e zhvillimit dhe të funksionimit të komunikacionit rrugor.

- Arsyeshmëria e varianteve dhe demonstrimi për secilën variant të projekti të funksionimit të tyre në aspektin e zhvillimit të qëndrueshëm urban.
- Demonstrimi dhe ofrimi i tregueseve të matshëm se si bizneset ekzistuese dhe shërbimet e tjera mund të mbeten funksionale, për secilën variant të propozuar.
- Vlerësimi i kostos së përgjithshme për secilën variant të propozuar të projektit, duke përfshirë:
  - Kostot e zhvendosjes eventuale të objekteve që pengojnë në realizim të secilit variant të projektit,
  - Kostot e prishjes apo rrënimeve gjatë fazës së realizimit të projektit,
  - Koston e infrastrukturës ekzistuese,
  - Kostot e ndërtimit, dhe fluksin e parave të projektit.
- Bën rekandime të detajuara për fazat e projektimit dhe ndërtimit të projektit, për secilin variant,
- Bën rekandime për formën optimale të kontraktimit të ndërtimit, për illojin e duhur të kontratës për secilin variant të propozuar.
- Ofron planin dinamik të përafërte të realizimit të projektit në teren për secilit variant të propozuar,
- Ofron zgjidhje racionale, për secilën variant të propozuar, për mënyrën e ndërtimit, duke përfshirë mbylljet e përkohshme të rrugëve, gjatë kohës së ekzekutimit të projektit në teren.
- Kontrollit të shpenzimeve.
- Masat e shëndetit dhe sigurisë.

Vërejtje: Projektet ideore në përgjithësi duhet të përbajnjë gjithë materialin e nevojshëm, si: Të dhëna bazë dhe të tjera, të nevojshme për përpilimin e projektit kryesor, si Bazat; Prerjet; Dukjet; 3D imazhet etj, Planin e situacionit (rrugët dhe shtigjet e brendshme, parkingjet, hapësirat rekreative, hapësirat gjelbëruese, hapësirat ndriqese, trotuare të ndryshme, shtigjet për bicikleta etj.). Përshkrim teknik, Paramasë dhe paralogari të përafërt etj.

Me këto të dhëna autoriteti kontraktues do të e ketë të mundur që në aspektin profesional, të vlerësoj secilin variant veq e veq, të propozuar nga operatori ekonomik, në mënyrë që të përzgjidhet nga varianti më optimal, duke e përbushur aspektin funksional dhe ekonomik të projektit.

➤ Vlerësimi i ndikimit në Mjedis(VNM).

- Vlerësimi i ndikimit në mjedis do të bëhet si tersi për katër variantet dhe po ashtu duhet të ofrohen rekandimet e domosdoshme për secilën variant veq e veq.

➤ Elaborati gjeomekanik,

	<p>Hartimi i elaboratit gjeomekanik, duke përfshirë inxhinierinë gjeologjike, gjeologjinë, dhe hidrogeologjine, si dhe informacionet të nevojshme rreth gjendjes ekzistuese të zonës ku do të bëhen variantet dhe rekondimimet e kërkuar, do të përmbytë :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Hyrjet bazike të elaboratit</li> <li>▪ Përshkrimi i projektit</li> <li>▪ Plani i hulumtimeve gjeoteknikë</li> <li>▪ Gjendja Ekzistuese Fushore</li> <li>▪ Metodologjia e hulumtimit Gjeoteknik</li> <li>▪ Punët Fushore</li> <li>▪ Testimet Laboratorike</li> <li>▪ Rezultatet e Hulumtimit</li> <li>▪ Gjeologjia e zonës</li> <li>▪ Hidrogeologjia e zones</li> <li>▪ Shpimet dhe Testimet fushore</li> <li>▪ Interpretimi i parametrave mekanike te shkëmbinjve</li> <li>▪ Karakteristikat Gjeoteknikë te Dherave</li> <li>▪ Kushtet e fondimit</li> <li>▪ Konkludime dhe Rekomandime</li> <li>▪ Po ashtu elaborati si shtojcat tjera të nevojshme, duhet të i bashkangjiten: Situacionet, Shpimet, Profilet Gjeoteknikë, Testet Fushore (SPT Test), Analizat e Fondimit, Ekzaminimet Laboratorike</li> </ul> <p>Pra në përgjithësi punët që do të zhvillohen për hartimin e elaboratit gjeomekanik kryesisht do të përfshijnë punët fushore, punët laboratorike dhe punët e përgatitjes së raporteve.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Si punë fushore janë: Shpimet në formë zigzage në distancë që 20m, Testimet fushore SPT në vrima të shpimit, Marrja e mostrave, Matja e nivelit të ujравe nëntokësore, Testimet fushore Cone Penetration Test (CPT) (spaku 1 copë që 100m), Testimet fushore seismike Multichannel Analysis of Surface Waves (MASW)</li> <li>▪ Si punët laboratorike janë: Përbajtja e lagështisë, Pesha vëllimore, Pesha specifike, Permbajtja e granulometrisë, Kufiri i rrjedheshmeris dhe plasticitetit, Testet e rrëshqitjes direkte, Testet e tri aksialit CD, CU, dhe UU, Testet e konsolidimit dhe Testet e shtypjes njeaksiale pa kufizim anësor</li> <li>▪ Raporti duhet të përmbytë: Profilet litologjike te shpimeve, Profilet e prerjes terthore gjate aksit dhe Raportet e testimeve Laboratorike.</li> </ul>
--	---

	<p>➤ Organizimi i dy takimeve me komunitetin dhe palët e interesit.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Organizimi i takimeve do të bëhet me qëllim të informimit të qytetareve dhe palëve të interesit të asaj zone pra lagjes Kalabria dhe Dardania.</li> <li>▪ Detyrë e operatori është përgatitja në aspektin teknik të takimeve( si Salla e takimit, pajisjet prezantuese dhe materialet informuese të printuara) si dhe prezantimi i varianteve të propozuara.</li> <li>▪ Ndërsa informimi i palëve të interesuara dhe të qytetareve për takime do të bëhet nga ana e Komunës së Prishtinës.</li> </ul> <p>Si kriteret shtesë për operatorin ekonomik:</p> <p>Gjatë hartimit të studimit të fizibilitetit , operatori ekonomik i kontraktuar do të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Punoj ngushtë me përfaqësuesit e Komunës së Prishtinës në arritjen e të gjitha qëllimeve të kontratës;</li> <li>▪ Do të raportoj për ecurinë, sipas kërkesës së menaxherit të kontratës;</li> <li>▪ AFATI I PËRFUNDIMIT „Studimi i fizibilitetit duhet përfundoj për 180 ditë pune.</li> <li>▪ Operatori Ekonomik duhet të i përbahet afatit të paraparë,</li> </ul> <p>Komuna e Prishtinës, do të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Siguroj informacionet e nevojshme për operatorin ekonomik të kontraktuar.</li> <li>▪ Informon me kohë operatorin ekonomik të kontraktuar për çdo ndryshim të mundshëm që ndikon në punën e përgatitjes së projektit detal.</li> <li>▪ Rishikon dhe jep komente rreth elaboratit për operatorin ekonomik të kontraktuar.</li> <li>▪ Përcjell operatorin ekonomik të kontraktuar për detyrat e dakorduara,</li> <li>▪ Ju lutemi vini re se gjatë procesit të ekzekutimit kontratës, Komuna e Prishtinës do të ruaj drejtën të kërkojë dokumentacion svarues në lidhje me studimin e fizibilitetit .</li> </ul> <p>Studimi i fizibilitetit për projektin ““Zgjidhja urb-arkitektonike e ndërlidhjes së lagjes “Kalabria” me lagjen “Dardania ” në përgjithësi ka karakter inxhinierik i ndërlidhur me aspektet tjera, që projekt do të ndikoj me zbatimin e tij në teren.</p>
<b>3. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT</b>	Studimi i fizibiliteti për projektin “ Zgjidhja urb-arkitektonike e ndërlidhjes së lagjes “Kalabria” me lagjen “Dardania ”
<b>3.1 Gjenerale</b>	Projekti “ Zgjidhja urb-arkitektonike e ndërlidhjes së lagjes “Kalabria” me lagjen “Dardania ” do të mundësoj shkarkimin e rrugës kryesore Shkup – Mitrovicë dhe do të lidhë lagjet Kalabria me Lagjen Dardania, duke mundësuar qarkullim shumë të shpejt dhe të lehtë. Po ashtu projekti do të ndikoj në përmirësimin e hapësirave gjelbëruese në lagjen Kalabria dhe Dardania.
<b>4. PËRGJEGJËSITË DHE DETYRAT E</b>	Përbajtja e Studimit të Fizibilitetit, që Operatori Ekonomik duhet të punojë është si më poshtë:

<b>OPERATORIT EKONOMIK</b>	Bazuar në këto terma të referencës
<b>4.1 Zyrat</b>	Autoriteti kontraktues nuk do të ofrojë zyra për nevojat e operatorit ekonomik
<b>4.2 Mjetet te cilat duhet te sigurohen na operatori ekonomik</b>	OE do të sigurojë që ekspertët janë të mbështetur në mënyrë adekuate dhe të pajisur me mjete të nevojshme të punës. Pra rezultatet e studimit të fizibilitetit të projektit duhet të janë brenda logjikës së projektit, duke ofruar rekomandime të sakta.
<b>4.3 Pajisjet</b>	Të gjitha pajisjet e nevojshme për studimin e fizibilitetit, me qëllim të arritjes së rezultateve të synuara duhet të sigurohen nga OE pa kosto shtese për AK.
<b>4.4 Shpenzimet e rastit</b>	Dispozita për shpenzime të rastit mbulohen nga OE në kuadër të kontratës.
<b>5. RAPORTET</b>	
<b>5.1 Kërkesat e Raportimit</b>	Raportet e ndërmjetme gjatë kohës së përgatitjes së studimit të Fizibilitetit.
<b>5.2 Dorezimi &amp; aprovimi i raporteve</b>	<p>Kopjet e raporteve të përmendura më lartë duhet të dorëzohen tek Menaxheri i Projektit identifikuar në kontratë. Raportet duhet të janë te shkruara në gjuhën shqipe si dhe sipas nevojës në gjuhët zyrtare që fliten në Republikën e Kosovës ose angleze. Menaxheri i Projektit është përgjegjës për miratimin e raporteve.</p> <p><b>DORËZIMI I STUDIMIT TË FIZIBILITETIT</b></p> <p>Pas aprovimit nga Komuna e Prishtinës të Draftit final duhet te dorëzohet ne 3 kopje fizike dhe 1 kopje digitale (PDF dhe DWG).</p>
<b>Monitorimi dhe vlerësimi behet nga Menaxheri i Projektit dhe Organi mbikëqyrës i projektit</b>	